



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c), nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 03.06.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Tajar Susuri**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Osman Hajdari
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Tajar Susuri, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 26.05.2022, nr.730/2022, për zëvendësimin e anëtari të Kuvendit Komunal z.Osman Hajdari, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Tajar Susuri.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 03.06.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datën 03.06.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së

- I. Miratohet formimi i grupit punues për Hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së, në këtë përbërje.
 1. Të gjithë anëtarët e KQZ-së,
 2. Drejtorët Departamenteve dhe Udhëheqësit e Divizioneve të SKQZ-së.
- II. Obligohet grupi punues për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 03.06.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniq